



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-016-17848

Me datë 22.04.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenin 53, lidhur me nenin 57, të Ligjit, Nr-05/L-031, për Procedurës e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-20/2016", e në mbështetje të nenit 22 paragrafi 3, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019", e në zbatim nenit 27, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, e duke vendosur sipas kërkesës me numër të protokollit 01-Nr-181-8883 të datës 20.02.2026 të parashtruar nga firma "Energie" sh.p.k me pronar Samir Berisha nga Suhareka, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shkëputjen e kontratës

- I. **SHKËPUTET**-kontrata me numër të protokollit, 01-Nr-16-32690, e datës 29.10.2020 dhe kontrata me numër të protokollit, 01-Nr-16-13662, e datës 26.02.2021, e lidhur në mes Komunës së Suharekës dhe firmës "Energie" sh.p.k me pronar Samir Berisha nga Suhareka, për shkak të mos përmbushjeve të obligimeve të parapara në kontratat në fjalë.
- II. **OBLIGOHET**- Drejtoria për shërbime pronëso-ro-juridike dhe kadastrë që në librat e kadastrave, firmën e lartcekur ta shlyejë si shfrytëzues i parcelave në fjalë dhe ta kthejë gjendjen e mëparshme juridike të parcelave.
- III. **OBLIGOHET**- Drejtoria për shërbime pronëso-ro-juridike dhe kadastrë në bashkëpunim me Drejtorinë për ekonomi, financa dhe buxhet, që obligimet e mbetura të pa paguara nga firma e lartcekur, ti ekzekuton (mbledh) konform ligjeve të aplikeshme në Republikën e Kosovës.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës në Suharekë.

A r s y e t i m

Firma "Energie" sh.p.k me pronar Samir Berisha nga Suhareka, ka bërë kërkesë me numër të protokollit 01-Nr-181-8883 të datës 20.02.2026, për shkëputjen e kontratës me vetë dëshirë, për shkak të vështërsive të kushteve financiare dhe mos paisjes me leje të ndërimit, kontratat të lidhur në mesë Komuna e Suharekës me datën 29.10.2020, me numër të protokollit, 01-Nr-016-32690 dhe 01-Nr-016-13662 të datës 26.02.2021 dhe firmës "Energie" sh.p.k me pronar Samir Berisha nga fshati Suhareka, për shfrytëzim afatshkurtër me qira të parcelës kadastrale **P-72116046-02080-0** me

sipërfaqe të përgjithshëm **S=2083m²** dhe parcela kadastrale **P-72116046-02050-0** me sipërfaqe të përgjithshëm **S=503m²** me destinim **“Ushtrimin e aktivitetit biznesor”**.

Kryetari i Komunes nga Drejtoria për shërbime pronëso-ro-juridike dhe kadastrë, ka kërkuar raport me shkrim lidhur me mbikëqyrjen e kontratave pasi që është organ kompetent për mbikëqyrjen e kontratave, drejtori në fjalë me raportin me shkrim me numer të protokollit 01-Nr-052-13846 të datës 27.03.2026 i ka rekomanduar Kryetarit të Komunës për shkëputjen e kontratave për shkak të mos përmbushjeve të obligimeve të parapara në kontratat në fjalë.

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit dhe administrimit të të gjitha dokumenteve që gjenden në lëndë, vendosi që ti shkëput kontratat sipas kërkesës së palës dhe rekomandimit të drejtorisë së lartcekur, të lidhur në mesë Komuna e Suharekës datën 29.10.2020, me numër të protokollit, 01-Nr-016-32690, dhe 01-Nr-016-13662 të datës 26.02.2021 dhe firmës “Energie” sh.p.k me pronar Samir Berisha nga fshati Suhareka, për shfrytëzim afatshkurtër me qira të parcelës kadastrale **P-72116046-02080-0** me sipërfaqe të përgjithshëm **S=2083m²** dhe parcela **P-72116046-02050-0** me sipërfaqe të përgjithshëm **S=503m²** me destinim **“Ushtrimin e aktivitetit biznesor”**, për shkak të mos përmbushjeve të obligimeve të parapara në kontratën në fjalë.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, Kryetari i Komunës në kuptim të nenit 53, 57 dhe 66, lidhur me 96 paragrafi 1 pika 1, të Ligjit, Nr-05/L-031, për Procedurës e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-20/2016”, në zbatim të nenit 22 paragrafi 3, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien e shfrytëzimit dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019”, dhe nenit 27, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij të vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim në procedurë administrative është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa, por me padi mund të iniciohet kontesti administrativ në Gjykatën Themelore, përkatësisht në Departamentin për çështje administrative në Prishtinë, në afat prej 30, ditësh prej ditës së dërgimit të këtij vendimin me shkrim. Inicimi i kontestit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Të njoftohen;
DSHJPK-ja
DEFB-ja
Pala
Evidenca


Kryetari i Komunës
Bali MUHARREMAJ